



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 20 dhjetor 2018**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1084\_2018**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 15, dhe Dispozitat e Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 8 Paragrafët 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 09.10.2018 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2019;

**në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2018, nxori këtë:**

## **VENDIM**

### **I. MIRATOHET dokumenti Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2019**

#### **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 09 tetor 2018 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2019** nga KOSTT Sh.A. ZRRE ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar të cilat komente janë përfshirë, apo çështjet e ngritura janë sqaruar. Pas përfshirjes së komenteve të shkruara, dokumenti është dërguar në ZRRE si version final për aprovim me datë 17 dhjetor 2018.
  - Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Energjinë, pas analizimit të dokumentit përfundimtar, ZRRE konsideron se dokumenti i përmbush kriteret për miratim, dhe duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi duke miratuar dokumentin **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2019**.
- II. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë elektrike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.
- III. Bilanci do të publikohet në faqen zyrtare të ZRRE-së si dokument unik i ZRRE së bashku me



Bilancin e energjisë termike 2019.

- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti i përbashkët për si Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe energjisë termike.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2019

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së,**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar